



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

RAPORT

**ANALIZA E VEPRIMTARISË FINANCIARE
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2021**

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

PËRMBAJTJA

A. Të ardhurat

B. Shpenzimet

Planifikimi buxhetor

Në mbështetje të Ligjit Nr.111/2018 “Për Kadastrën”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka përgatitur Programin Buxhetor për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 24 Drejtoritë Vendore për vitin 2021.

Në zbatim të Vendimit Nr.6, datë 13.01.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2021” i ndryshuar dhe në mbështetje të shkresës Nr.1028 prot., datë 20.01.2021 “Dërgohet detajimi i buxhetit për vitin 2021”, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka kryer detajimin e fondeve buxhetore dhe detajimin e limiteve mujore për drejtoritë e vendore të ASHK-së. Ky proces është realizuar edhe për numrin e punonjësve, të miratuar për Institucionin (në strukturë dhe me kontratë).

Menaxhimi dhe monitorimi i fondeve të veta buxhetore (Të Ardhurat dhe Shpenzimet)

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka kryer menaxhimin dhe monitorimin periodik të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Vendore të ASHK-së, për çdo muaj dhe progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2021. Në përbushje të detyrimit ligjor janë përgatitur periodikisht dhe çdo muaj evidencat e monitorimit të shpenzimeve dhe të të ardhurave të realizuara nga shërbimet e regjistrimit dhe nga legalizimi.

Përgatitja e pasqyrave financiare për zbatimin e buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2021, u bë në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2021, janë administruar dhe menaxhuar fondet sipas programit:

- Të ardhura (Nga shërbimet dhe legalizimet)
- Shpenzime

A. Të Ardhurat

Të ardhurat në total për periudhën Janar – Dhjetor 2021 janë realizuar në masën 3,227,750,405 lekë, ose 137.7% krahasuar me planin ose 884,384,300 lekë më shumë, të ardhurat e realizuara nga regjistrimi (ofrimi i shërbimeve kadastrale) janë realizuar në masën 2,329,968,449 lekë ose 128.7% ,ose 520,439,239 lekë më shumë, dhe të ardhurat e realizuara nga legalizimi (parcelë ndërtimore +të tjera) janë realizuar në masën 897,781,956 lekë ose 168% , ose 363,945,062 lekë më shumë, të cilat janë paraqitur në mënyrë tabelare si më poshtë:

Të ardhurat e ASHK në total (regjistrimi+legalizimi) 2021		
Periudha	Plani Janar -Dhjetor 2021	Fakti Janar – Dhjetor 2021
	2,343,366,105	3,227,750,405

Të ardhurat e ASHK në total nga regjistrimi		
Periudha	Plani Janar -Dhjetor 2021	Fakti Janar – Dhjetor 2021
	1,809,529,210	2,329,968,449

Të ardhurat e ASHK në total nga legalizimi		
Periudha	Plani Janar -Dhjetor 2021	Fakti Janar – Dhjetor 2021
	533,836,894	897,781,956

Ndërsa të krahasuara me vitin 2020 të ardhurat e realizuara nga regjistrimi dhe legalizimi në mënyrë tabelare dhe grafike paraqiten si më poshtë:

Te ardhura nga regjistrimi dhe legalizimi per vitet 2020-2021 në lekë


Nr	Periudha	Te ardhura nga regjistrimi		Te ardhura nga legalizimi	
		2020	2021	2020	2021
1	JANAR	95,772,253	154,383,695	20,555,884	51,666,124
2	SHKURT	124,972,220	173,230,467	30,622,197	61,004,997
3	MARS	72,048,997	197,909,714	15,221,749	102,682,342
4	PRILL	78,959,099	199,535,031	17,847,545	124,227,447
5	MAJ	68,934,941	189,119,693	56,338,562	65,867,052
6	QERSHOR	140,205,357	199,562,252	105,792,267	92,752,517
7	KORRIK	162,358,702	173,932,616	70,710,687	52,772,950
8	GUSHT	134,336,298	193,926,854	55,552,874	49,999,700
9	SHTATOR	174,378,773	174,194,202	76,806,550	96,376,971
10	TETOR	180,387,196	230,736,352	93,553,982	77,825,827
11	NENTOR	156,955,576	187,442,596	59,407,345	67,575,481
12	DHJETOR	185,909,109	255,994,976	88,378,618	55,030,547

TOTAL	1,575,218,521	2,329,968,449	690,788,260	897,781,956
--------------	----------------------	----------------------	--------------------	--------------------

Të ardhura regjistrim+legalizim 2021/2020

në lekë

Nr	Periudha	2020	2021
1	JANAR	116,328,137	206,049,819
2	SHKURT	155,594,417	234,235,464
3	MARS	87,270,746	300,592,056
4	PRILL	96,806,644	323,762,478
5	MAJ	125,273,503	254,986,746
6	QERSHOR	245,997,624	292,314,770
7	KORRIK	233,069,389	226,705,566
8	GUSHT	189,889,172	243,926,554
9	SHTATOR	251,185,323	270,571,174
10	TETOR	273,941,178	308,562,179
11	NENTOR	216,362,921	255,018,077
12	DHJETOR	274,287,727	311,025,523
13	TOTAL	2,266,006,781	3,227,750,405



Në realizimin e të ardhurave mbi plan ka ndikuar rritja e të ardhurave nga shërbimet për regjistrimin të cilat krahasuar me planin janë realizuar në masën 128.7% dhe rritja e të ardhurave nga legalizimi në masën 168% mbi plan, e cila vjen si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave nga parcela ndërtimore në tërësi, nga parcela ndërtimore në zonat e stimuluar dhe shërbime të tjera legalizimi (Kërkesat për legalizim për shtesat dhe oborret në përdorim).

Në realizimin e të ardhurave nga regjistrimi peshën më të madhe e zenë të ardhurat nga shërbimet e mëposhtme:

- 1) Lëshim certifikate pronësisë (17.98% të totalit të të ardhurave)
- 2) Lëshim kopje kartelesh të pasurisë (15.78% të totalit të të ardhurave)
- 3) Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale (11.97% të totalit të të ardhurave)
- 4) Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim gjykate apo akt administrativ 9.72%

Në të ardhurat nga shërbimet **nuk përfshihen:**

1. Të ardhurat që ASHK vjel dhe derdh në buxhetin e shtetit si agjent tatimor për:
 - Tatimin mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë (15%)
 - Tatimin mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë (3% nga rivlersimi)
2. Të ardhurat që ASHK vjel nga legalizimi
 - Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe zonat e stimuluar për ATP-në (pëkatësisht në masën 70% dhe 50%)

Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe Zonat e Stimuluara për ATP dhe tatimi i kalimit të pronësisë nga rivlerësimi 3% dhe nga 15% sipas tabelës më poshtë:

Në lekë

Nr	Emërtimi	Vlera 15%	Vlera 3%	Vlera ATP
1	Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i pronësisë 15%	200,197,966		
2	Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i pronësisë 3%(Për rivlersimin)		4,824,829,256	
3	Të ardhurat nga parcela ndërtimore dhe zonat e stimuluar për ATP-në			1,441,401,290
	-Transferuar në ATP			1,238,267,020

Krahasimisht, të ardhurat nga rivlersimi (3%) dhe të ardhurat nga tatimi i kalimit të pronësisë (15%), rezultojnë se në vlerë absolute ndryshimi është 4,624,631,290 lekë sipas akt-rakordimeve vjetore të Drejtorive Vendore të ASHK-së, shumë e cila ka kaluar në Drejtorinë e Tatimeve. Kjo tregon se rivlersimi ka patur shumë ndikim në rritjen e tatimit të kalimit të pronësisë.

Të ardhurat nga Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë

Në zbatim të Ligjit Nr.9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ardhurat që ASHK vjel si agjent tatimor për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, derdhen:

- a) 97% për buxhetin e Bashkisë apo Njësisë Administrative, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

b) 3% në buxhetin përkatës të Drejtorive Vendore të ASHK-së, në llogaritë respektive jobuxhetore.

NR	EMERTIMI	VLERA
1	TIRANA VERI	6,695,583
2	TIRANA JUG	4,293,699
3	DURRËS	2,575,207
4	TIRANA RURALE 2	1,543,780
5	TIRANA RURALE 1	1,232,278
6	VLORË	1,213,286
7	FIER	1,051,497
8	ELBASAN	785,043
9	KORÇË	725,205
10	SHKODER	556,220
11	SARANDË	314,933
12	LEZHË	310,417
13	KAVAJË	299,450
14	KAMËZ -VORË	212,570
15	BERAT	207,526
16	LUSHNJE	177,014
17	KRUJË	146,793
18	POGRADEC	111,236
19	GJIROKASTER	91,049
20	KUÇOVË	9,691
21	DIBER	4,032
22	KUKËS	2,872
23	TEPELENË	2,498
24	TOTALI	22,561,878



Të ardhurat totale nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për periudhën Janar - Dhjetor 2021 janë **22,561,878** lekë.

Drejtoritë Vendore të ASHK-së që kanë patur më shumë kalime pronësie të pasurive të cilat kanë qenë në pronësi të subjekteve tregtare janë: Drejtoria Vendore e

ASHK-së Tiranë Veri, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Jug, Drejtoria Vendore e ASHK-së Durrës, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Rurale 2, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Rurale 1, Drejtoria Vendore e ASHK-së Vlorë, Drejtoria Vendore e ASHK-së Fier, Drejtoria Vendore e ASHK-së Elbasan, Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë, Drejtoria Vendore e ASHK-së Shkodër, Drejtoria Vendore e ASHK-së Sarandë, etj.

Numri i shërbimeve nga regjistrimi

Njësia aktuale e matjes së nivelit të punës në sistemin e regjistrimit është “shërbimi”. Në këtë kontekst një “shërbim” është çdo transaksion që ndodh në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës kur kërkohet një kopje e kartelës, një kërkesë për lëshimin e çertifikatës, një kërkesë për regjistrimin e një dokumenti apo kërkesa për shërbime të tjera, gjithsej 72 shërbime të ndryshme që ofron Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 numri i shërbimeve është 1,260,237 dhe është realizuar 124.9% krahasuar me planin dhe 143% krahasuar me vitin 2020. Në mënyrë tabelare paraqitet si më poshtë:

Numri i shërbimeve të ofruara nga ASHK Janar-Dhjetor 2021		
	Plani	Fakti
Total	1,009,123	1,260,237

Numri i shërbimeve të ofruara nga ASHK Janar-Dhjetor 2020-2021		
	Fakti 2020	Fakti 2021
Total	880,158	1,260,237

Shërbimet të cilat zenë peshën specifike më të madhe janë:

- 1) Lëshim certifikate pronësjie 20.37%
- 2) Lëshim fragment harte kadastrale 20.2%
- 3) Lëshim kopje karteles 26.8 %

B. Shpenzimet nga të ardhurat

Në mbështetje të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, në bazë të Urdhërit Nr.84, datë 02.05.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” dhe në zbatim të Udhëzimeve “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Njësitë shpenzuese të Institucionit tonë (DP dhe DV) vazhdojnë veprimtarinë e tyre në bazë të të ardhurave të realizuara, nga të cilat kryejnë shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve, mallra dhe shërbime dhe investime sipas buxhetit të disponueshëm të planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2021

1. Shpenzimet e personelit për çdo njësi shpenzuese janë kryer në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.6 datë 13.01.2021 “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2021” i ndryshuar, Urdhërit Nr. 84 datë 02.05.2019 “Per miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” si dhe VKM-së Nr.245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës” (Për punonjësit në organikë dhe ato me kontratë të përkohëshme).

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime dhe fond të veçantë për cdo njësi shpenzuese rezulton si më poshtë:

Shpenzimet për sistemin e ASHK-së për zërat 600,601,606 (Paga, sigurime, fond i veçantë):

NR	EMERTIMI	Totali 600-Paga (struktura +kontrate)		Totali 601(Struktura+ kontrat)		Totali 606 (Fondi I veçantë)	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	DREJTORIA E PËRGJITHSHME ASHK	190,968,750.0	151,881,589	30,871,030	24,933,035	46,214,782	626,500
2	TIRANA VERI	82,701,120	74,448,864	13,802,789	12,399,754	71,000	69,607
3	TIRANA JUG	83,375,904	72,173,747	13,915,478	12,113,259	124,000	104,656
4	TIRANA RURALE 1	81,714,144	69,422,750	13,637,964	11,646,056	264,000	254,380
5	TIRANA RURALE 2	82,051,536	69,443,884	13,694,309	11,599,582	104,000	98,280
6	DURRËS	81,602,832	70,881,598	13,619,375	11,829,006	150,000	150,000
7	ELBASAN	95,662,944	89,796,336	15,967,414	15,152,326	231,000	181,000
8	VLORË	89,574,240	75,539,901	14,950,600	12,378,923	30,000	30,000
9	KAMËZ -VORË	81,936,144	70,224,955	13,675,038	11,745,256	30,000	30,000
10	SHKODER	78,140,400	67,597,080	13,041,149	11,227,533	30,000	30,000
11	FIER	74,772,096	66,796,173	12,478,642	11,423,759	94,000	79,900
12	KORÇË	58,909,824	50,901,803	9,829,643	8,487,712	-	0
13	LEZHË	62,906,448	53,611,104	10,497,079	8,944,638	-	0
14	BERAT	40,029,456	32,169,414	6,676,621	5,394,732	-	
15	KAVAJË	36,503,376	33,021,177	6,087,766	5,709,250	208,000	208,000
16	GJIROKASTER	38,165,616	31,395,446	6,365,360	5,237,893	118,000	117,125
17	KRUJË	25,632,432	18,623,876	4,272,318	3,121,882	-	
18	LUSHNJE	43,958,256	40,262,564	7,332,731	6,706,404	60,000	60,000
19	POGRADEC	23,321,088	19,708,894	3,886,324	3,261,471	-	0
20	SARANDË	40,972,128	35,482,354	6,834,047	5,915,228	-	
21	DIBER	27,923,328	24,812,358	4,654,898	4,138,207	-	0
22	KUKËS	27,585,936	22,924,149	4,598,553	4,097,618	-	
23	ZONAT E STIMULUARA	38,661,756	30,987,464	6,448,215	5,191,809	-	
24	KUÇOVË	8,502,720	7,659,766	1,419,954	1,275,543	-	
25	TEPELENË	7,671,840	6,122,974	1,281,197	1,022,339	-	30,000
26	TOTALI	1,503,244,314	1,285,890,220	249,838,493	214,953,213	47,728,782	2,069,448

2. Shpenzimet operative dhe investimet janë shpërndarë për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 24 Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2021 duke u mbështetur në limitin buxhetor të planifikuar dhe në nevojat që kanë këto drejtori.

Përsa i përket realizimit të shpenzimeve operative dhe investimeve për çdo njësi për periudhën Janar –Dhjetor 2021 rezultojnë si më poshtë:

Shpenzimet për sistemin e ASHK-së për zërat 602, 231, 230 (shpenzime operative, investime)

NR	EMERTIMI	SHPENZIME OP. 602		INVESTIME 231		INVESTIME 230	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	DREJTORIA E PËRGJITHSHME ASHK	383,624,000	117,714,676	889,350,711	21,623,458	626,788,000	212,957,456
2	TIRANA VERI	18,356,000	16,139,394	1,500,000	1,402,800		0
3	TIRANA JUG	17,875,000	16,061,914	1,200,000	838,200		0
4	TIRANA RURALE 1	13,180,000	10,995,179	1,200,000	1,055,520		0
5	TIRANA RURALE 2	12,600,000	11,257,500	1,200,000	954,720		0
6	DURRËS	17,836,000	20,284,772	2,160,000	2,005,800		0
7	ELBASAN	17,153,000	14,013,306	1,200,000	1,008,000		0
8	VLORË	13,462,000	13,318,655	1,200,000	983,760		0
9	KAMËZ -VORË	12,800,000	11,313,456	1,320,000	984,000		0
10	SHKODER	15,982,000	13,717,182	1,200,000	1,125,600		0
11	FIER	15,276,000	11,370,584	1,200,000	848,350		0
12	KORÇË	16,069,000	12,000,352	2,880,000	2,744,424		0
13	LEZHË	18,037,000	17,790,965	1,200,000	1,199,000		0
14	BERAT	11,954,000	10,518,363	600,000	594,000		0
15	KAVAJË	11,690,000	9,754,296	600,000	550,080		0
16	GJIROKASTER	8,364,000	6,269,588	600,000	539,280		0
17	KRUJË	6,605,000	5,798,784	800,000	531,921		0
18	LUSHNJE	10,969,000	10,342,053	1,560,000	1,457,760		0
19	POGRADEC	4,299,000	3,518,410	700,000	401,880		0
20	SARANDE	8,400,000	6,822,036	500,000	600,000		0
21	DIBER	5,500,000	3,027,833	1,200,000	900,500		0
22	KUKËS	7,240,000	7,238,585	1,000,000	874,680		0
23	ZONAT E STIMULUARA	5,679,000	1,194,194	600,000	545,040		0
24	KUÇOVË	2,050,000	830,179	500,000	358,680		0
25	TEPELENË	6,800,000	5,604,657	500,000	345,600		0
26	TOTALI	661,800,000	356,896,913	915,970,711	44,473,053	626,788,000	212,957,456

PERMBLEDHESHE E SHPENZIMEVE OPERATIVE JANAR-DHJETOR 2021				
Artikulli	Emertimi	Plan 2021 ne 000/leke	Fakti 2021 ne leke	Realizimi ne %
	<<Emertimi i Programit>>			
602.0	Materiale zyre dhe te pergjithshme	61,910	40,596,536	66%
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	3,540	3,097,139	87%
602.2	Sherbime nga te trete	227,510	169,872,833	75%
602.3	Shpenzime transporti	15,335	9,391,993	61%
602.4	Shpenzime udhetime	15,830	6,148,200	39%
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	23,215	13,640,375	59%
602.6	Shpenzime per qeramarrje	118,375	74,568,190	63%
602.7	Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	184,300	29,346,841	16%
602.9	Shpenzime te tjera operative	11,785	10,234,807	87%
	Totali	661,800	356,896,913	54%

Në zërin shpenzime për qeramarrje rezulton me rritje për arsye të marrjes së objekteve me qera për Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Vendore të dëmtuara nga tërmeti të llogaritura në kushtet e emergjencës nga fatkeqësitë natyrore, si dhe Vendimit Nr. 8, datë 28.05.2021 të Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me të cilën u vendos zhvendosja e ambienteve të Drejtorive Vendore të ASHK-së, Durrës dhe Krugë, në Qarkun Tiranë, ku jemi detyruar të marrim ambjente me qera për këto drejtori.

Ndërsa në zërin shpenzime për investime puna ka qenë e përqëndruar në drejtim të rikonstruksionit për objektet e dëmtura nga tërmeti, të cilat janë në vazhdimësi të punimeve me qëllim lënjen e objekteve me qera dhe në drejtim të zhvillimit të sistemeve të IT.

Përmbledhëse e investimeve Janar-Dhjetor 2021			Në 000/lek
Artikulli	Lloji I investimit	Plani 2021	Fakti Janar –Dhjetor 2021
231	Rikonstruksione	600,000	8,311
231	Orendi zyre	286,414	1,432
231	Pajisje kompjuterike , printera , kondicioner, kamera sigurie	29,557	22,705
231	Popullim dhe pershtatje e regjistrit elektronik të PP për projektin "Nafta për Fermeret"	13,080	12,026
231	Totali 231	915,971	44,473
230	Auditim energjitik për Vlorën	13,560	4,198
230	Mirëmbajtja e arkivës digjitale të përmirësuar	12,456	11,418
	Projekti permiresim- perditesimit dhe regjistrimit fillestar	303,000	197,341
230	Totali 230	329,016	212,957
230+231	Investime Gjithsej (230+231)	1,244,987	257,431

PROJEKTI PËRMIRËSIM /PËRDITËSIMIT DHE REGJISTRIMIT FILLESTAR JANAR-DHJETOR 2021					
Shpenzimet për projektin , të detajuara sipas nënartikujve dhe analizave përkatëse	Paga	Sigurime	Udhëtim I brendshëm	TOTALI	PLANI VJETOR
nr.llog.	600	601	6,024,100		
VLERA	166,903,596	27,696,452	2,741,180	197,341,228	303,000,000

Për mbulimin e shpenzimeve për periudhën Janar- Dhjetor 2021 Drejtoritë Vendore kanë përdorur të ardhurat e veta të realizuara nga shërbimet e regjistrimit dhe nga legalizimi. Në të ardhurat e tyre përfshihen dhe të ardhurat e realizuara nga parcela ndërtimore pjesa që i takon institucionit.

Sipas tabelës së mëposhtme pasqyrohet rezultati financiar i secilës Drejtori:

REZULTATI FINANCIAR JANAR- DHJETOR 2021

NR	EMERTIMI	NUMRI SHERBIMEVE	TE ARDHURA PER ASHK-NE	SHPENZIME	DIF. ARDHURA- SHPENZIME
1	DREJTORIA E PERGJITHSHME	417	55,605,559	529,736,715	-474,131,155.5
2	TIRANA VERI	151,886	438,562,658	104,460,419	334,102,238.6
3	TIRANA JUG	95,453	283,391,201	101,291,776	182,099,425.1
4	TIRANA RURALE 1	102,559	230,123,055	93,373,885	136,749,170.0
5	TIRANA RURALE 2	77,042	199,079,258	93,353,966	105,725,292.0
6	DURRËS	86,188	246,024,837	105,151,176	140,873,661.0
7	ELBASAN	86,828	177,033,996	120,150,968	56,883,027.8
8	VLORË	72,388	249,125,254	102,251,239	146,874,014.4
9	KAMËZ -VORË	47,522	168,847,731	94,297,667	74,550,064.2
10	SHKODER	62,527	116,078,427	93,697,395	22,381,031.7
11	FIER	68,350	117,552,066	90,518,766	27,033,300.5
12	KORÇË	64,213	112,831,168	74,134,291	38,696,876.5
13	LEZHË	54,705	143,240,643	81,545,706	61,694,936.7
14	BERAT	42,823	67,117,191	48,676,508	18,440,682.2
15	KAVAJË	52,480	120,594,597	49,242,803	71,351,794.0
16	GJIROKASTER	20,968	46,627,035	43,559,332	3,067,702.7
17	KRUJË	16,087	29,798,253	28,076,463	1,721,790.0
18	LUSHNJE	42,589	91,589,367	58,828,781	32,760,585.9
19	POGRADEC	21,445	37,767,128	26,890,654	10,876,473.2
20	SARANDE	48,956	150,887,836	48,819,618	102,068,217.9
21	DIBER	18,421	34,866,463	32,878,898	1,987,565.3
22	KUKËS	10,888	21,731,267	35,135,032	-13,403,765.6
23	ZONAT E STIMULUARA	0	60,438,840	37,918,507	22,520,333.0
24	KUÇOVË	8,400	14,776,662	10,124,168	4,652,494.5
25	TEPELENË	7,102	14,059,915	13,125,570	934,345.1
	TOTALI	1,260,237	3,227,750,405	2,117,240,304	1,110,510,101

Gjatë vitit 2021 sipas rezultatit financiar rezulton se në përgjithësi Drejtoritë Vendore të ASHK-së kanë mbuluar shpenzimet me të ardhurat e realizuara.

Në mënyrë të përmbledhur në zbatim të buxhetit të ardhurat dhe shpenzimet e ASHK-së për periudhën Janar - Dhjetor 2021, paraqiten si më poshtë:

ZBATIMI I BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2021

(E ardhura për tu trashëguar në vitin 2022)		Në 000/lekë		Në Lekë
Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI JANAR - DHJETOR 2021(I miratuar)VKM nr.6,datë 13.01.2021	BUXHETI JANAR - DHJETOR 2021(I rishikuar) Miratuar me VKM nr. 464 dt.30.07.2021	REALIZIMI JANAR-DHJETOR 2021
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	3,607,530	4,344,786	5,859,856,435
1	Të ardhura nga shërbimet	1,640,000	1,809,529	2,329,968,449
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore pjesa takuese e institucionit	210,000	377,893	637,965,897
3	Të ardhura të tjera	90,000	155,944	259,816,059
4	Fonde që trashëgohen nga viti 2020	1,667,530	1,979,420	1,979,420,307
5	Fonde të akorduara nga MBZHR		22,000	
6	Buxheti i shtetit (financim per 2022 sipas VKM Nr. 747 , datë 9.12.2021)			652,000,000
7	Fonde te ngurtësuarra të vitit 2020			685,723
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	3,607,530	4,344,786	2,117,240,303
1	Shpenzime personeli	1,793,562	1,800,812	1,502,912,881
	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të miratuar	948,609	954,585	800,100,900
	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit në organikë	157,236	158,212	134,296,472
	Paga për punonjësit me kontratë(690)	548,660	548,660	485,789,320
	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit me kontratë	91,626	91,626	80,656,741
	Fondi i vecantë i pagave	47,430	47,729	2,069,448
2	Shpenzime operative	600,000	661,800	356,896,913
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	450,000	511,800	356,896,913
	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	150,000	150,000	-
3	Shpenzime Kapitale	1,109,268	1,542,759	257,430,509
a	Investime kapitale të patrupëzuara	396,588	626,788	212,957,456
	Drejtoria e Projektit të përmirësim përditësimit (300)	303,000	303,000	197,341,228
	Shpenzime për investime tjera të patrupëzuara(IT)	93,588	323,788	15,616,228
b	Investime kapitale të trupëzuara(Rikonstrukcion +Infrastruktura IT)	712,680	915,971	44,473,053
	Rikonstrukcione(Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+Vlore)	600,000	600,000	8,310,538
	Infrastruktura e sistemeve te IT+ blerje paisje dhe orendi)	112,680	253,291	24,136,835
	Popullim dhe pershtatje e regjistrimit elektronik te PP per ofrimin e sherbimit Leshim ekstrakti informues.....	-	13,080	12,025,680
	GPS për Drejtoritë Vendore		49,600	-
4	Fondi Rezervë	104,700	104,700	0
	Fondi Rezervë	104,700	104,700	
5	Të ardhura të pashpërndara(tejkalim plani 4/Mujori 2021	0	234,716	
6	Fonde të ngurtësuarra për vitin 2021(5% garanci)			1,045,095
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME(Vlera e të ardhura për tu trashëguar në vitin 2022 , me fondin rezervë)	0	0	3,741,571,037
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME(Vlera e të ardhura për tu trashëguar në vitin 2022 , pa fondin rezervë)			3,636,871,525

Totali i të ardhurave për tu trashëguar për vitin 2022 rezulton të jetë 3,741,571,037 lekë.

Fondi rezervë

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.218 datë 20.03.2013 “Për miratimin e kufijve dhe kriterëve të përdorimit të fondit rezervë të ish Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për vitin 2020” nuk u planifikua Fond rezervë.

Fondi rezervë i krijuar për vitet 2013, 2014 dhe 2015 i cili ka vlerë 104.700 mijë lekë në total, nuk është përdorur. Në zbatim të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, ky fond rezervë i akumuluar trashëgohet dhe mund të përdoret në rast nevojë për mbulimin e dëmshpërblimeve.

Punoi: Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit
 Shpresa Kallaku
 Specialist i sektorit të Buxhetit
 Meri Berisha

Pranoi: Drejtor i Njësisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
 Brikena Dervishaj

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
ARTAN LAME